

Kalatat 7-8 në dispozicion të kroçerave të mëdha

16 Dhjetor 2011



Kalatat 7 dhe 8 në portin detar të Durrësit do të kthehen në një shesh ankorimi dhe pritjeje për anije të mëdha turistike.

Përfaqësues të lartë të agjencive të njohura “Costa Crociere” dhe “MSC” kanë mbërritur muajt e fundit në Durrës, ku kanë shprehur interesimin e tyre për një bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Autoritetin portual në fushën e lundrimeve me kroçera turistike.

Kalatat 7 dhe 8 do të jenë krejtësisht në dispozicion të ankorimit të kroçerave me kapacitet 2500-3000 udhëtarë.

Ndërkaq përpunimi i mineraleve dhe qymyrit do të spostohet krejtësisht në kalatën 10, rikonstrukcioni i plotë i së cilës do të përfundojë së shpejti. Thellimi i basenit dhe kanalit hyrës të portit do ta ndihmojë lundrimin e kroçerave drejt Durrësit.

Që nga viti 2006 numri i kroçerave në portin e Durrësit ka ardhur duke u rritur. “Artania”, kroçera e fundit që ka mbërritur në portin detar më 11 nëntor të këtij viti, ka sjellë në vendin tonë 1.106 turistë, ndërsa kapaciteti mesatar i anijeve turistike që kanë mbërritur deri tani në portin detar arrin në 200-400 turistë.